



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 21.08.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1302/23, për zyrtaren znj. Pranvera Prestreshi, ish-zëvendës Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren znj. Pranvera Prestreshi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI). Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportuesi i rastit (DPKI-06/1302/23).

Konkretisht, janë ngritur pretendimet për konflikt të interesit për shkak të dyshimeve se zyrtarja znj. Pranvera Prestreshi, ka marrë pjesë në vendimmarrje lidhur me subjektin juridik - shoqërinë tregtare "K. K." SH.P.K., ndërkohë që e njëjta ka afërsi me subjektin në fjalë pasi që, siç pretendohet, djali i vëllaut të bashkëshortit të saj (djali i kunatit) në vitin 2015, e ka përfaqësuar (person i autorizuar) subjektin juridik "K. K." SH.P.K. në një rast pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (në vijim: ARBK).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar këtë çështje vetëm në kontekst të dyshimeve për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, sa i përket vendimmarrjes së znj. Pranvera Prestreshi, atëherë zëvendës Drejtoreshë e Përgjithshme e

ARBK-së, lidhur me vendimet: nr. 309, i datës 14.06.2023; nr. 311, i datës 15.06.2023 dhe nr. 333, i datës 21.06.2023, në raport me subjektin juridik - shoqërinë tregtare "K. K." SH.P.K.

Agjencia nuk ka trajtuar dhe shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të sipërpërmendura dhe as rregullsinë e procedurës për nxjerrjen e këtyre vendimeve, pasi që çështjet e tilla nuk janë në kompetencë të Agjencisë sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06-02/1319/23, e ka njoftuar zyrtaren znj. Pranvera Prestreshi lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjenci, me ç'rast zyrtarja në fjalë është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket këtyre pretendimeve.

Në takimin e mbajtur dhe përmes shkresës sqaruese të dorëzuar në Agjenci (DPKI-06-02/1319-1/23), përfshirë korrespondencat (e-mailet) plotësuese, znj. Pranvera Prestreshi ka paraqitur pozicionin dhe argumentet e saj përkitazi me pretendimet e ngritura, ku ndër të tjera ka deklaruar se: *"[...] B. P. është avokat dhe njëherit djali i kunatit tim (vëllaut të burrit). Në vitin 2015, në bazë të autorizimit që i është dhënë (autorizim i noterizuar dhe me vulë apostile) ka nënshkruar një kontratë për bartje për K. K.. Kjo kontratë ka qenë pjesë përbërëse e dokumentacionit që është dorëzuar në ARBK për ndryshime në informatat e biznesit dhe jo në çertifikatën e regjistrimit. Në këtë periudhë [...] nuk kam punuar dhe nuk kam pasur asnjë pozitë në sektorin e regjistrimit të bizneseve e rrjedhimisht as në ndryshimet që bëhen në një subjekt. [...] jam caktuar në pozitën e zv. Drejtores të ARBK-së më datë 24.02.2023 dhe këtë funksion e kam ushtruar deri më datë 21.06.2023 [...]. B. P., as si avokat e as në ndonjë cilësi tjetër, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë në ARBK për korrigjimin, ndryshimin, plotësimin apo çfarëdo veprimi tjetër, për dhe në emër të K. K., si pasojë e të cilave paska ardhë deri tek shfuqizimi i vendimit për pezullim të çertifikatës së regjistrimit. Vendimi për shfuqizim nuk është nxjerrë në bazë të ndonjë kërkesë nga ana e tij por sipas kërkesës së bërë [...] nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të K. K. SH.P.K. [...] edhe sikur të kishte një kërkesë të parashtruar nga ana e B. P., e që në nuk është, ai është djali i kunatit tim (djali i vëllaut të burrit) që nuk hyn në kategorinë e anëtarëve të familjes (personave të afërm) sipas ligjit [...]"*

Me qëllim të marrjes së qëndrimit (versionit) të ARBK-së lidhur me 'konstatimin' e konfliktit të interesit dhe ushtrimin e ndikimit, sa i përket vendimmarrjes së znj. Pranvera Prestreshi, ish-zëvendës Drejtoreshës së Përgjithshme të ARBK-së, dhe lidhur me atë se cila është dhe si është konstatuar afërsia e zyrtarës në fjalë, me subjektin tregtar "K. K." SH.P.K., Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06/02/1450/23, ka kërkuar nga zëvendës Drejtoresha (aktuale) e ARBK-së informata dhe sqarime, përfshirë dokumentacionin relevant dhe bazën ligjore. Agjencia ka pranuar nga ARBK përgjigjen përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1450-1/23.

Më pas, me qëllim të vërtetimit të lidhjes (eventuale) familjare përkatësisht afërsisë së znj. Pranvera Prestreshi me B. P. e rrjedhimisht edhe me subjektin juridik "K. K." SH.P.K., Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06/02/1440/23, ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Agjencia ka pranuar nga ARC - MPB përgjigjen dhe dokumentacionin përmes shkresës zyrtare DPKI-06-1440-1/23.

Nga informatat dhe dokumentacioni i bashkangjitur të pranuar prej raportuesi i rastit, takimi i mbajtur dhe shkresat sqaruese të dorëzuara në Agjenci nga znj. Pranvera Prestreshi, përgjigja dhe dokumentacioni i bashkangjitur nga ARBK dhe nga ARC - MPB, si dhe nga informatat e siguruar sipas detyrës zyrtare, Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me Vendimin Ref. Nr.01/09, i datës 24.02.2023, të Ministres së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), zyrtarja znj. Pranvera Prestreshi është caktuar zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së.

Me Vendimin Ref. Nr.01/50, i datës 21.06.2023, të Ministres së MINT, sipas paragrafit 1, L.H. është emëruar zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së, ndërsa me paragrafin 2 të këtij vendimi është shfuqizuar Vendimi Ref. Nr.01/09, i datës 24.02.2023, me të cilin znj. Pranvera Prestreshi ishte caktuar në pozitën si më lartë.

Rjedhimisht, zyrtarja znj. Pranvera Prestreshi ka ushtruar funksionin zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së, nga data 24.02.2023 deri më datë 21.06.2023.

Me Vendimin Nr. 309, i datës 14.06.2023, të Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së në MINT, është pezulluar certifikata e biznesit të kompanisë “K. K.” SH.P.K., e datës 29.05.2020. Vendimi është nënshkruar nga znj. Pranvera Prestreshi, në cilësi të zëvendës Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së.

Me Vendimin Nr. 311, i datës 15.06.2023, të Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së në MINT, është korrigjuar Vendimi Nr. 309, i datës 14.06.2023, për shkak të një gabimi në preambulë. Vendimi është nënshkruar nga znj. Pranvera Prestreshi, në cilësi të zëvendës Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së.

Me Vendimin Nr. 333, i datës 21.06.2023, të zëvendës Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së, është shfuqizuar Vendimi 309, i datës 14.06.2023, me të cilin ishte pezulluar certifikata e biznesit të kompanisë “K. K.” SH.P.K., e datës 29.05.2020. Vendimi është nënshkruar nga znj. Pranvera Prestreshi, në cilësi të zëvendës Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së.

Me Vendimin Nr. 336, i datës 21.06.2023, të zëvendës Drejtores së Përgjithshme të ARBK-së, sipas paragrafit 1, është anuluar Vendimi 333, i datës 21.06.2023, ndërsa sipas paragrafit 2 të këtij vendimi, ka mbetur në fuqi Vendimi Nr. 309, i datës 14.06.2023 dhe Vendimi Nr. 311, i datës 15.06.2023. Vendimi është nënshkruar nga L. H., në cilësi të zëvendës Drejtores (aktuale) së Përgjithshme të ARBK-së.

Vendimi Nr. 309, i datës 14.06.2023 dhe Vendimi Nr. 311, i datës 15.06.2023, përmbajnë vetëm logon zyrtare të MINT, ndërsa Vendimi Nr.333, i datës 21.06.2023 dhe Vendimi Nr. 336, i datës 21.06.2023, përmbajnë logon zyrtare të MINT dhe atë të ARBK-së.

Në arsyetimin e Vendimit Nr. 336, i datës 21.06.2023, ndër të tjera, theksohet se: *“Vendimi i datës 21 qershor 2023, me numër 333, i nxjerrë nga znj. Pranvera Prestreshi që ushtronte detyrën e Drejtores së Agjencisë për Regjistrimin e Biznesit, është nxjerrë nën rrethanat e konfliktit të interesit, marrë parasysh marrëdhënien familjare ndërmjet zyrtares së lartë dhe avokatit B. P. të palës K. K. SH.P.K., certifikata e biznesit e të cilës ishte pezulluar [...]”*

Në vendimin si më sipër dhe as në përgjigjen e ARBK-së dhe dokumentacionin e bashkangjitur, nuk është 'konstatuar' dhe as 'konfirmuar' afërsia (lidhja) e zyrtares znj. Pranvera Prestreshi me B. P., përkatësisht me subjektin tregtar "K. K." SH.P.K., si dhe nuk është 'konstatuar' dhe as 'konfirmuar' se si ARBK ka ardhur deri tek konstatimi i konfliktit të interesit.

Andaj, për vërtetimin e afërsisë (gjinisë së krushqisë) të znj. Pranvera Prestreshi me B. P., është kërkuar që fillimisht të vërtetohet lidhja ndërmjet zyrtarës në fjalë me I. P. (nëse është bashkëshorti i saj), e më pas lidhja ndërmjet I. P. me S. P. përkatësisht me B. P. (nëse është vëllau përkatësisht djali i vëllaut të bashkëshortit të saj).

Referuar përgjigjes së ARC - MPB, rezulton se znj. Pranvera Prestreshi me I. P. janë bashkëshortë. Ndërsa, sa i përket lidhjes ndërmjet I. P. (bashkëshortit të znj. Pranvera Prestreshi) me S. P. përkatësisht me B. P., ARC - MPB ka theksuar se "[...] nuk mund të konfirmojmë lidhjen e mundshme familjare mes tyre".

Megjithatë, me qëllim të vërtetimit të afërsisë (gjinisë së krushqisë) të znj. Pranvera Prestreshi me B. P., përveç provës si më lartë (përgjigjes nga ARC - MPB), Agjencia ka shqyrtuar dhe administruar edhe prova tjera, siç janë: shkresa e dërguar në Agjenci e znj. Pranvera Prestreshi, mandej certifikatat dhe ekstraktet e gjendjes civile të pranuar nga ARC - MPB, si dhe prova tjera të siguruar nga Agjencia, sipas të cilave rezulton se, B. P. është djali i vëllaut (nga babai) të bashkëshortit të saj, gjegjësisht djali i kunatit të saj.

Rrjedhimisht, raporti i afërsisë familjare ndërmjet zyrtares znj. Pranvera Prestreshi dhe B. P., është lidhje (afërsi) e gjinisë së krushqisë në shkallën e tretë.

Sipas përgjigjes së ARBK-së dhe dokumentit "Fletëparaqitje për ndërrim të pronarëve - aksionarëve", rezulton se B. P., në cilësi të personit të autorizuar të subjektit juridik "K. K." SH.P.K., më datë 03.12.2015, ka parashtruar kërkesë në ARBK për ndryshim të pronarit të subjektit në fjalë.

Nga përgjigja e ARBK-së dhe dokumentacioni i bashkangjitur, përfshirë katër vendimet e sipërpërmendura të kësaj Agjencie lidhur me çështjen, si dhe nga provat tjera në shkresat e lëndës, nuk është gjetur se B. P. të ketë qenë përfaqësues i autorizuar i subjektit "K. K." SH.P.K., apo në çfarëdo cilësie të jetë përfshirë në procedurat përkatëse pranë ARBK-së, në periudhën kohore nga data 24.02.2023 deri më datë 21.06.2023, kur zyrtarja znj. Pranvera Prestreshi ka ushtruar funksionin zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së.

Në këtë kontekst, Agjencia e ka vlerësuar si të mirëqenë deklaratën që zyrtarja znj. Pranvera Prestreshi e ka dhënë në shkresën e dorëzuar në Agjenci, me të cilën deklaronte se, [...]. B. P., as si avokat e as në ndonjë cilësi tjetër, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë në ARBK për korrigjimin, ndryshimin, plotësimin apo çfarëdo veprimi tjetër, për dhe në emër të K. K., si pasojë e të cilave paska ardhë deri tek shfuqizimi i vendimit për pezullim të certifikatës së regjistrimit. Vendimi për shfuqizim nuk është nxjerrë në bazë të ndonjë kërkesë nga ana e tij por sipas kërkesës së bërë [...] nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të K. K. SH.P.K. [...].

Për më tepër, në bazë të informatave publike për bizneset në uebfaqen zyrtare të ARBK-së, personi në fjalë (B. P.) nuk figuron as pronar/aksionar e as përfaqësues i autorizuar i subjektit

juridik "K. K." SH.P.K. dhe/apo subjektit tjetër tregtar "K. M. I. H." SH.P.K., i cili është aksionar i "K. K." SH.P.K.

Përveç sa u tha më lartë, Agjencia nuk e ka vlerësuar të nevojshme andaj nuk është lëshuar tutje në konstatimin e faktit nëse B. P. ka qenë apo është i angazhuar (përveç në vitin 2015) tek subjekti juridik "K. K." SH.P.K., pasi që një gjë e tillë është jo relevante duke marrë parasysh se raporti i afërsisë familjare ndërmjet zyrtares znj. Pranvera Prestreshi dhe B. P., rezulton të jetë lidhje (afërsi) e gjinisë së krushqisë në shkallën e tretë.

Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 lidhur me nenin 17 të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: "*Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka **interes privat**, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare*", ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: "*Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së **interesit të tij privat** ose të **personave të afërm** me të lidhur me **vendimmarrjen** në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.*"

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: "*interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për **personin zyrtar**, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste*", dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: "***Person i afërm me zyrtarin** është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë [...]. Për qëllime të këtij ligji, **personi juridik konsiderohet si person i afërm**, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.*"

Në lidhje më këtë, me nenin 113 [Përkufizimet], paragrafi 6, të Kodit Nr. 06/L-074 penal të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: "*Person juridik - subjekti juridik i vendit apo i huaj, i cili sipas legjislacionit të Kosovës në fuqi konsiderohet si person juridik.*" Me nenin 417 [Konflikti i interesit], paragrafi 5 të këtij kodi, është përkufizuar se: "*Për qëllime të këtij neni, shprehja 'person juridik që ka të bëjë me të' - nënkupton personin juridik në të cilin zyrtari apo anëtar i familjes ka marrëdhënie financiare aktuale apo të ardhshme, përfshirë **marrëdhënien afariste** ose të **punës** apo dobi financiare të çfarëdo natyre. Ndërsa, me paragrafin 6 të këtij neni është përkufizuar se: "*Për qëllimet e këtij neni, një **anëtar i familjes** do të thotë bashkëshorti ose bashkëshortja, prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar,**

vëllai ose motra, gjyshi ose gjyshja, nipat e mbesat nga vajza dhe djali, hallat dhe tezet, nipat e mbesat nga vëllai dhe motra, dajët dhe axhallarët, njerku/njerka, thjeshtri/thjeshtra, vëllai /motra nga njëri prind, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore.”

Për më tepër, me nenin 75 [Natyra e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe e Aksionit], paragrafi 1, të Ligji Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare, është përcaktuar se: “Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është **person juridik** [...].”

Përveç kësaj, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e definojnë nocionin vendimmarrje si: “*çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.*”

Në rastin konkret, është fakt se znj. Pranvera Prestreshi, në cilësi të zëvendës Drejtoreshës së ARBK-së, ka qenë pjesë e vendimmarrjes në raport me subjektin juridik “K. K.” SH.P.K. në tre vendime (nr. 309, i datës 14.06.2023; nr. 311, i datës 15.06.2023 dhe nr. 333, i datës 21.06.2023), por në kuptim të dispozitave të sipërcituara, personi B. P. nuk hyn në mesin e personave të afërm të saj, pasi që siç u theksua më lartë, me nenin 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6. të LPKI-së, personi i afërm në gjini të krushqisë konsiderohet vetëm deri në shkallën e dytë, ndërsa në rastin konkret, znj. Pranvera Prestreshi me B. P. është lidhje (afërsi) të gjinisë së krushqisë në shkallën e tretë. Pra në këtë rast, nuk ka lidhje familjare që është brenda shkallës së ndaluar me dispozitat e LPKI-së (gjinia e krushqisë - shkalla e dytë).

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitës së nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6. të LPKI-së, lidhur me dispozitat e sipërcituara të nenit 113 dhe 417 të Kodit Nr. 06/L-074 penal të Republikës së Kosovës, as subjekti juridik “K. K.” SH.P.K. të cilin B. P. në vitin 2015 e ka përfaqësuar në një rast në raport me ARBK-në, nuk konsiderohet person juridik i afërm i zyrtarës znj. Pranvera Prestreshi.

Andaj, nga sa u tha më lartë, Agjencia konstatoi se vendimmarrja e znj. Pranvera Prestreshi, në cilësi të (atëherë) zëvendës Drejtoreshës së Përgjithshme të ARBK-së, lidhur me vendimet: nr. 309, i datës 14.06.2023; nr. 311, i datës 15.06.2023 dhe nr. 333, i datës 21.06.2023, në raport me subjektin juridik - shoqërinë tregtare “K. K.” SH.P.K., nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit sipas dispozitave të LPKI-së.

Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: “*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*”

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit